



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2034 Regj
Nr. 807 Prot

Tiranë, më 19.06.2023

U R D H Ë R

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: “Tosk Energji” sha me Nipt L51817007A
Adresa: Shkoder, Lagjja Bahçallek, Rruga Tirana. Tel (0692101809)
Per dijeni: Dega e Doganes Fier
Adresa: Fier

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim te:

1. Urdhërit të Ekzekutimit Nr.342 date 20.10.2021, të Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore, dhe titullit ekzekutiv Vendimi i sekuestros Nr.2110 Prot date 18.05.2021”, leshuar nga Dega e Doganes Fier”, dosje me Nr.2034 Regj, datë 01.06.2023.
2. Urdhërit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.344/42 Regj.Them date 18.02.2022 i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore, dhe Titullit të Ekzekutimit “Vendim Nr.2113 date 18.05.2021, “Per rikuperimin me force të detyrimit doganor qe debitori...”, dosje me Nr.2035 Regj, datë 01.06.2023.
3. Urdhërit të Ekzekutimit” Vendimi Nr.343/41 Regj.Them date 18.02.2022 i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore dhe Titullit të Ekzekutimit Vendim Nr.2111 date 18.05.2021, “Per rikuperimin me force të detyrimit doganor qe debitori...” dosje me Nr.2036 Regj., datë 01.06.2023.
4. Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.107 Regj.Them date 05.05.2022 i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore dhe Titullit të Ekzekutimit “Vendim Nr.1057/3 date 20.10.2021 dosje nr.2037 date 01.06.2023.
5. Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.111 Regj.Them date 24.02.2022 i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore dhe Titullit të Ekzekutimit Vendim Nr.1054/2 date 20.10.2021, “Per rikuperimin me force të detyrimit doganor qe debitori...” dosje nr.2038 date 01.06.2023.
6. Urdherit të Ekzekutimit Vendimi Nr.108 date 24.02.2022”, i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore dhe titullit ekzekutiv, “Vendimi i sekuestros Nr.1056/2 Prot date 20.10.2021 “Per rikuperimin me force të detyrimit doganor qe debitori.” dosje nr.2039 date 01.06.2023.
7. Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.341/40 date 18.02.2022”, i Gjykatës Administrative të Shkalles së Pare Vlore, dhe titullit ekzekutiv Vendimi i sekuestros Nr.2112 Prot date 18.05.2021,” Per rikuperimin me force të detyrimit doganor qe debitori...” dosje nr.2040 date 01.06.2023.

kam vënë në ekzekutim këto Urdhëra, duke regjistruar në dosjet përmbarimore kërkesën e kreditorit Dega e Doganes Fier ndaj debitorit “Tosk Energji” sha me Nipt L51817007A, në lidhje me titujt ekzekutiv të leshuar nga Dega e Doganes Fier.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimet për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimet që përmbajne Urdherat e Ekzekutimit, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

“Debitori “Tosk Energji” sha me Nipt L51817007A nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Me vendimin per bashkimi dosjesh nr.804 date 19.06.2023 eshte vendosur bashkimi i dosjeve te sipercituara pasi rezultojne me te njejten pale debitore dhe kreditore.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit "Tosk Energji" sha me Nipt L51817007A ne masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 36 pika (e), 37 pikat (c) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore "Tosk Energji" sha me Nipt L51817007A me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

**ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI**

